

Hapet thirrja për bursa për stafi akademik në kuadër të Programit Erasmus + në Universitetin e St. Kliment Ohridski, Bullgari, për semestrin e dytë të vitit akademik 2021-2022.

Në kuadër të programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në Universitetin St. Kliment Ohridski, Bullgari për semestrin e dytë të vitit akademik 2021-2022.

<https://www.uni-sofia.bg/eng>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e stafit akademik me kohë të plotë për mësimdhënie;

Kohëzgjatja e bursave:

- 5 ditë + 2 ditët e udhëtimit;

Fushat e mësimdhënies:

- Gjuhë Frënge;
- Gjuhë Bullgare;
- Gjuhë Shqipe;
- Biologji.

Për t'u njohur me katalogun e programeve ju lutem referohuni linkut:

<https://erasmus.uni-sofia.bg/site/income/erasmus/grading-scale/course-list-2021-2022/>

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin ditor për stafin (140 EUR në ditë);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentet e nevojshme për aplikim për stafin akademik me kohë të plotë për mësimdhënie:

- CV + Lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj (për stafin në fushën e biologjisë);
- Vërtetim nëse keni kryer apo jo më parë një mobilitete Erasmus+ (nëse po, ku);
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për mësimdhënie klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility_Agreement_Teaching_outgoing-1-1.docx

*Plani i Mobilitetit për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat, i cili është Koordinator i Institucional i Erasmus +.

Afati për aplikim: **14 Janar 2022**

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!